Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e pranimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Agnese Ibrahimi	**04.07.2024**	**05.07.2024**	**2024/0569**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 28.06.2024, OE "FIN COMPANY SH.P.K."- Ferizaj, ka parashtruar ankesë me nr: 2024/0569, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE "NNT BINNI SH.P.K."- Shtedim, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me elemente te parafabrikuara nga betoni" me nr. të prokurimit: "1909466981031194-24-3857-1-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – NDËRMARRJA PUBLIKE BANESORE SH.A..

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 120,600 €.

Fazat e procedurës së prokurimit:

Njoftimi për kontratë: 19/04/2024

Hapja e ofertave: 10/05/2024

Vendimi i AK-së: 12/06/2024

Nëse është e përsëritur ankesa, të shënohet se lidhur me këtë lëndë nuk është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP - së, më Nr. 2024/0569 i dt:28.06.2024.Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Me date 12.06.2024, permes Njoftimit mbi Vendimin e AK-se kemi pranuar letren standarde si tenderues i eliminuar, me arsyetimin se: Nuk e keni bashkangjitur nje kontrate per furnizime.

Kjo nuk qendron per faktin se ne si GOE jemi i pergjegjshem por AK, nuk ka kerkuar sqarime shtese per ta vertetuar pasi qe ne si OE jemi me çmim me te lire dhe kjo shume lehte mund te vertetohet nga AK sipas nenit 59.2 dhe 72 te LPP-së.

Te bashkangjitur gjeni kriterin e kerkuar si ne DT dhe Njoftim per kontrate.

Kriteri i DT-se per kete pike:

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional:	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*
a. Operatori Ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka realizuar me sukses kontrata të natyrës së ngjashme (sëpaku një kontratë për furnizime me materiale të ngjashme) në tri vitet e fundit nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë. Shuma totale e kontratave të realizuara të jetë në vlerë jo më pak se 150,000.00 € (njëqind e pesëdhjetë mij) euro. Në rast të konzorciumit, lideri i grupit duhet ta përmbushë sëpaku 51 % të vlerës. b. Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka të angazhuar personel staf të mjaftueshëm profesional e teknik. Minimum 8 punëtorë të cilët duhet të jenë të çertifikuar nga MMPS apo ndonjë organizatë e licencuar, për Siguri dhe Shëndet në punë si dhe për Mbrojtje nga Zjarri. c. Operatori Ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka kryer vlerësimin e riskut për vendin e punës.	**a. Një listë e kontratave të natyrës së njejtë apo të ngjashme (e nënshkruar dhe e vulosur) të realizuara në 3 vitet e fundit nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë, duke saktësuar furnizimet e kryera, shumën e kontratës, datën dhe pranuesit; (i) kur punimet janë kryer për një autoritet publik në Kosovë ose në një vend tjetër, për dëshmi shërbejnë (referenca pozitive ose raporti i pranimit teknik) të lëshuar ose të bashkë-nënshkruar nga autoriteti i tillë. (ii) kur furnizimet punët janë kryer për një person apo kompani private, për dëshmi shërben kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi siç janë; (referenca pozitive, raportet e pranimit apo kontrata), por që këto dokumente të jenë të pranueshme duhet të dëshmohen me transaksion bankar ose faturë tatimore të shitjes ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e shërbimeve të realizuara. b. Një listë e personelit stafit profesional dhe teknik (e nënshkruar dhe e vulosur), bashkë me dokumentet përcjellse si - kontratat valide të punës për secilin prej tyre (origjinale të nënshkruara dhe vulosura nga punëdhënësi dhe punëmarrësi, ose kopje të noterizuara të dorëzohen të skanuara); - çertifikatat për siguri dhe shëndet në punë për secilin prej tyre (origjinal ose kopje të noterizuara); dhe -**
	çertifikatat për mbrojtje nga zjarri për secilin prej tyre, (origjinal ose kopje të noterizuara). c. Raportin e vlerësimit të Riskut për vendin e punës (kopje e noterizuar).

Nga kriteri i kerkuar kerkohet se paku nje kontrate per furnizime..

Ne si OE Fin Company, kemi kontrata te shumta, ku ne kontrate shkruan: Shtrim me kubeza betoni, kjo nenkupton se e kemi kryer furnizimin dhe montimin e kubezave, kjo me se miri vertetohet nga paramasa e bashkangjitur bashke me kontrate ku shkruan shume qarte **Furnizim me kubeza, Furnizim me anesor etj.**

Ne rast se ju si AK keni pas nevoj per sqarime ka qene dasht te kerkoni sqarime sipas nenit 59.2 dhe 72 te LPP-se, ku ne kontratat e bashkangjitura jane kontratat edhe per furnizim.

Te bashkangjitur gjeni proven (kontraten dhe paramasen), qe e deshmon se kriteri i kerkuar i DT-se dhe NJK-se permbushet, konkretisht te pika a e kriterit te dosjes se tenderit.

Te bashkangjitur gjeni kontraten qe e deshmon se mbi 73% eshte furnizim, kurse pozicionet e tjera jane te montimeve.

Republika e Kosovës * Republic of Kosova
Komuna * Municipality
Hani i Elezit

DATE: 13.10.2023
NR.09/ 8714 /2023

KONTRATË PËR PUNË

Numri i kontratës:[1]: **659-23-7755-5-2-1/C455 & KKHE-23-045-5-2-1**

KOMUNA HANI I ELEZIT, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë; dhe

FIN COMPANY SH.P.K., Varosh, Ferizaj, (ne vazhdim "Kontraktuesi"), ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontrate publike për pune e shënuara me poshtë:

Ndërtimi i trotuarit për këmbsorë (Rr.Adem Jashari,Udha e Shkronjave,Driton Loku) KKHE - 23-045-5-2-1 me numër identifikues: **659-23-7755-5-2-1**

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i punëve në vijim nga ana e Kontraktuesit: **Ndërtimi i trotuarit për kembsorë (Rr.Adem Jashari,Udha e Shkronjave,Driton Loku) Furnizim dhe punim i tamposit, Punim i sipërfaqe te trotuarit tek kyqjent e objekteve,parcelave Furnizim dhe vendosja e skajoreve Furnizim dhe vendosja e kubezave te betonit Punimi i rrethojes dhe punet tjera sipas paramases te bashkangjitur ne platform**

No.	Lot
1	**Ndërtimi i trotuarit për këmbsorë (Rr.Adem Jashari,Udha e Shkronjave,Driton Loku) KKHE - 23-045-5-2-1**

Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi total i punëve duhet të jetë: **23.090.00 €**; [*Njëzetë e tremijë e nëntëdhjetë euro/00 cent*].

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

Pra, edhe pse titulli i kontrates eshte Ndertimi i trotuarit, kjo nenkuptohet shume mire se nuk mund te behet ndertimi apo meremetimi i trotuarit pa i furnizuar edhe kubezat, ku me lehte per tu bindur i keni pozicionet e paramases qe ua kemi bashkangjitur me poshte e qe e deshmon se ne si OE kemi kryer edhe furnizimin ne kete kontrate.

PARAMASA DHE PARALLOGARIA

A	Ndertimi i trotuarit për këmbësor në Han të Elezit në Rr.Adem Jashari, Udha e Shkronjave, Driton Loku, Paldenicë (Trotuari në Rr.Adem Jashari).

Në çmimi duhet të përfshihet furnizimi I materialit ,instalimi dhe sjellja e produktit në gjendje funksionale .Te gjitha produktet duhet te jene kualitative dhe ofertuesi ne ofertën e tij duhet të përfshije certifikatat e kualtitetit dhe te standarteve si dhe broshurat apo katalogjet e produkteve me te dhenat teknike te produktit me te cilat merr pjese ne tender.Kontrollimi dhe evidentimi i instalimeve nëntokësore, zgjedhja e problemeve eventuale që lidhen me planin operativ të ndërtimit si dhe përpilimi i planit detal operativ që lidhet me procesin e ndërtimit. Në çmim të llogaritet edhe kosto eventuale e detektimit me aparatura elektronike për instalime nëntokësore si dhe evidentimi i saktë i instalimeve që duhet të mirëmbahen gatë kohës se ndërtimit dhe ne rast demtimi te behet riparimi i tyre (rrjeti elektrik, rrjeti i telefonisë shtepiake,rrjeti i ujesjellesit etj) dhe infrastruktua mbitokesore.

I.I	PUNET E TROTUARIT	Njesia	Sasia	Çmimi/njesi	Vlera €
1.2.6	Furnizimi me material dhe punimi i tamponit (100MN/m²) prej gurit të thyer gëlqeror 0-31.5mm me trashësi t=10 cm,ketu hyjne trotuari dhe pjesa e kanlait nga B/A.	m^2	255.00	10.00	2,550.00
1.2.7	Punimi I uljeve te trotuarve tek kyçjet e objekteve,parcelave sipas detalit te dhen ne pjesen grafike.	m^1	20.00	3.25	65.00
1.2.8	Furnizimi dhe vendosja e skajoreve 18/24 kualiteti i kërkuar sipas EN1340:2003, soliditeti në lakim, min klasa-2/T, dhe kritereti tjera ngrirje shkrirje-krypëra, abrazion.	m^1	455.00	10.00	4,550.00
1.2.9	Furnizimi dhe vendosja e skajoreve 10/20 kualiteti i kërkuar sipas EN1340:2003, soliditeti në lakim, min klasa-2/T, dhe kritereti tjera ngrirje shkrirje-krypëra, abrazion.	m^1	455.00	7.00	3,185.00
1.2.10	Furnizimi dhe vendosja e kubëzave te betonit me trashesi t=8cm duke perfshire edhe rreren 0-4 per te vene ne veper kubzat,kualiteti i kërkuar sipas EN1340:2003, soliditeti në lakim, min klasa-2/T, dhe kritereti tjera ngrirje shkrirje-krypëra, abrazion.Forma e tyre perzgjedhet nga investitori.	m^2	910.00	10.00	9,100.00
1.4.8	Punimi I rrethojes sipas Detaleve te paracitura ne projekt .Te cilat kane ne permbatje : profil metalik HOP 100x100x5 Distanca ne mes te profilave L=220 cm Laresia e Profilit se bashku me pjesen e ankeruar H=110 cm. Te parashihet edhe punimi I bazes nga B/A Ne kete Pozicion ta parashihet edhe vendosja e Zingjireve nga shtylla ne shtylle nga materiali i plastikes (ngjyra te perzgjedhet nga mbykqyrsi)	m^1	455.00	8.00	3,640.00
	TOTALI:I.I				23,090.00

REKAPITULIMI

Nr.	Pershkrimi i pozicionit	Gjithsej
I.I	PUNET E TROTUARIT	
	TOTALI me TVSH:	€ 23,090.00

VEREJTJE : Te gjitha taksat e aplikueshme duhet te kalkulohen ne cmime

Mund ta shiqoni pozicionin 1.2.8; 1.2.9 dhe 1.2.10, , ku e deshmon se ne kete kontrate eshte kryer furnizimi dhe kjo e deshmon se kjo kontrate ka qene mbi 73 % furnizim apo kap vleren 16,835 €, kurse pozicionet e tjera montime. Pra sipas nenit 59.4 te LPP-se, ne si GOE i permbushim kriteret e kerkuara te DT-se, konkretisht listes se kontratave.

Poashtu vlen te ceket se edhe OE i rekomanduar ka kontrata te njejta..

Me date 14.06.2024 kemi bere kerkese per rishqyrtim prane AK- NP.BANESORE dhe AK me date 19.06.2024 na e refuzon kerkesen per rishqyrtim me arsyetim se nuk kemi referenca te furnizimit.

Pra, siq e sqaruam edhe me larte se ne si OE kemi reference te furnizimit, jo vetem nje por kemi shume referenca qe ne pershkrim quhet tituli: Shtrim me kubeza apo shtrim I trotuareve dhe nga ajo paramase mbi 70% jane furnizim siq I kemi sqaruar edhe me larte: Furnizim me kubeza, furnizim me trotuare, furnizim me zhavorr etj.

Vlen te potencohet se ne si GOE kemi cmimin me te lire se OE i rekomanduar , ku ne kemi ofertuar me cmim 91,533.00 €, kurse OE i rekomanduar ka ofertuar me cmim 103,775.00 €, ku AK e ka demtuar buxhetin publik ne vlere prej 12,242.00 €, ku ka bere shkeljen e nenit 1 dhe 6 te LPP-se.

Pra ne jemi GOE me i lire se OE i rekomanduar per 12,242.00 €.

Poashtu edhe na keni diskriminuar neve keni bere shkeljen e nenit 7 te LPP-se, duke e shperblyer me kontrate OE me cmim me te shtrenjte.

Pra, duke u bazuar ne nenin 1, 6, 7, 69 dhe 72 te LPP-se, ju si AK nuk ka kerkuar sqarime shtese dhe te shperblehemi si GOE i pergjegjshem me cmim me te lire!

Pra, AK ka bere shkeljen e dispozitave ligjore dhe kjo ndikon qe AK te bej demtimin e buxhetit publik, ashtu sic e kemi sqaruar edhe ne brendi te kesaj ankese.

Ne rast se nuk merren vendime te merituara ndaj neve si Operator te demtuar ne do ti ndjekim te gjitha rruget ligjore.

KRITERET PËR VLERËSIM

9.1 & 9.2	**Kapaciteti teknik dhe professional** **a. Operatori Ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka realizuar me sukses** kontrata të natyrës së ngjashme (sëpaku një kontratë për furnizime me materiale të ngjashme) në tri vitet e fundit nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë. Shuma totale e kontratave të realizuara të jetë në vlerë jo më pak se 150,000.00 € (njëqind e pesëdhjetë mij) euro. Në rast të konzorciumit, lideri i grupit duhet ta përmbushë sëpaku 51 % të vlerës. **b. Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka të angazhuar personel/staf të mjaftueshëm profesional e teknik.** Minimum 8 punëtorë të cilët duhet të jenë të çertifikuar nga MMPS apo ndonjë organizatë e licencuar, për Siguri dhe Shëndet në punë si dhe për Mbrojtje nga Zjarri. **c. Operatori Ekonomik duhet të ofroj dëshmi** se ka kryer vlerësimin e riskut për vendin e punës.	***Dëshmia e kërkuar dokumentare:*** ***a. Një listë e kontratave të natyrës së njejtë apo të ngjashme (e nënshkruar dhe e vulosur)*** *të realizuara në 3 vitet e fundit nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë, duke saktësuar furnizimet e kryera, shumën e kontratës, datën dhe pranuesit; (i) kur punimet janë kryer për një autoritet publik në Kosovë ose në një vend tjetër, për dëshmi shërbejnë (referenca pozitive ose raporti i pranimit teknik) të lëshuar ose të bashkë-nënshkruar nga autoriteti i tillë. (ii) kur furnizimet/punët janë kryer për një person apo kompani private, për dëshmi shërben kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi siç janë; (referenca pozitive, raportet e pranimit apo kontrata), por që këto dokumente të jenë të pranueshme duhet të dëshmohen me transaksion bankar ose faturë tatimore të shitjes ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e shërbimeve të realizuara.* ***b. Një listë e personelit/stafit profesional dhe teknik (e nënshkruar dhe e vulosur),*** *bashkë me dokumentet përcjellse si:* *- kontratat valide të punës për secilin prej tyre (origjinale të nënshkruara dhe vulosura nga punëdhënësi dhe punëmarrësi, ose kopje të noterizuara të dorëzohen të skanuara);* *- çertifikatat për siguri dhe shëndet në punë për secilin prej tyre (origjinal ose kopje të noterizuara); dhe* *- çertifikatat për mbrojtje nga zjarri për secilin prej tyre, (origjinal ose kopje të noterizuara).* ***c. Raportin e vlerësimit të Riskut për vendin e punës*** *(kopje e noterizuar).*

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

NDËRMARRJA PUBLIKE BANESORE

Adr: Rr. "Zija Shemsiu", nr.22, Ulpianë - Prishtinë
Tel: +383 (0) 38 606 670; +383 (0) 38 606 672; 0800 11 672
e-mail: mirembajtja@npbanesore.com; info@npbanesore.com

Nr. Prot. DP - 01/2024
Datë: 19.06.2024

Në mbështetje të *Neni 108/A (pika 6 dhe 8.4) e Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, dhe të Nenit 61 (pika 61.3) Nenit 62 (pika 62.1 – d) dhe 62.2) dhe Nenit 63 (pika 63.1, nënpika 63.1.1 – a.) të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik,* sipas Kërkesës për Rishqyrtim të datës 15.06.2024 (e Shtunë) ora 14:17, të parashtruara **nga Operatori Ekonomik FIN COMPANY SH.P.K.,** e pranuar në Departamentin e Prokurimit përmes platformës elektronike E-Prokurimi, për aktivitetin e prokurimit: **Furnizim me elemente të parafabrikuara nga betoni,** me nr. të prokurimit: **1909466981031194-24-3857-1-2-1** dhe nr. i brendshëm: **NPB 24 021 121,** Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit nxjerr këtë:

A K T V E N D I M
MBI REFUZIMIN E KËRKESËS PËR RISHQYRTIM SI TË PABAZË PAS VLERËSIMIT

I. **Refuzohet** si e pabazuar Kërkesa për Rishqyrtim nga Operatori Ekonomik FIN COMPANY SH.P.K., për aktivitetin e prokurimit: **Furnizim me elemente të parafabrikuara nga betoni,** me nr. të prokurimit: **1909466981031194-24-3857-1-2-1** dhe nr. i brendshëm: **NPB 24 021 121,** i shpallur nga Autoriteti Kontraktues – Ndërmarrja Publike Banesore Sh. A.;

II. **Vërtetohet** Njoftimi mbi Vendimin i Autoritetit Kontraktues Ndërmarrja Publike Banesore Sh. A., për aktivitetin e prokurimit: **Furnizim me elemente të parafabrikuara nga betoni,** me nr. të prokurimit: **1909466981031194-24-3857-1-2-1** dhe nr. i brendshëm: **NPB 24 021 121;**

III. **Autorizohet** Autoriteti Kontraktues Ndërmarrja Publike Banesore Sh. A. të pres së paku 10 ditë kalendarike me efekt nga dita pas datës në të cilën Autoriteti Kontraktues ka marrë një vendim;

IV. **Obligohet** Autoriteti Kontraktues Ndërmarrja Publike Banesore Sh. A., që refuzimin e kërkesës për rishqyrtim të ja komunikoj parashtruesit të ankesës dhe të gjitha palëve të interesuara;

V. **Aktvendimi** i Autoritetit Kontraktues është i detyrueshëm për Autoritetin Kontraktues dhe duhet të zbatohet menjëherë;

VI. **Aktvendimi** hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

n/a

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

n/a

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

n/a

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **FIN COMPANY SH.P.K.**

Sqarim hyrës: OE ankues ka parashtruar ankesë pranë OSHP-së, si palë e pakënaqur me vendimin e marrë nga autoriteti kontraktues për eleminimin e këtij operatori. Pretendimet të cilat janë ngritur përmes ankesës, janë shqyrtuar nga eksperti i cili ka dhënë përgjigje si më poshtë.

Pretendim

OE ankues pretendon që:*"AK na ka eleminuar me arsyetimin se nuk kemi bashkengjitur një kontratë për furnizime. Kjo nuk qëndron për faktin se ne si GOE jemi te përgjegjshëm por AK nuk ka kërkuar sqarime shtesë për ta vërtetuar pasi që ne jemi Oe me çmimin më të lirë. Ne si kompani kemi kontrata të shumta, ku në kontratë shkruan: Shtrim me kubëza betony, kjo nënkupton se e kemi kryer edhe furnizimin dhe montimin e kubëzave, kjo më së miri vërtetohet nga paramasa e bashkëngjitur bashkë me kontratë ku shkruan shumë qartë Furnizim me kubëza, furnizim me anësor etj. Pra, edhe pse tituli i kontrates është ndërtimi i trotuarit, kjo nënkuptohet shumë mirë se nuk mund të bëhet ndërtimi apo meremetimi i trotuarit pa i furnizuar edhe kubëzat, ku më lehte për tu bindur i keni pozicionet e paramasës që ua kemi bashkengjitur më poshtë e që e dëshmon se ne si OE kemi kryer edhe furnizimin në këtë kontratë."*

Eksperti shqyrtues sqaron se një nga kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional, përkatësisht kërkesa *a* e FDT-së ka qenë që *operatorët ekonomik duhet të ofrojnë dëshmi se kanë realizuar me sukses kontrata të natyrës së ngjashme (së paku një kontratë për furnizime me materiale të ngjashme) në tre vitet e fundit nga data e publikimit të njoftimit për kontratë, me vlerë jo më pak se 150,000.00 euro dhe si dëshmi është kërkuar një listë e kontratave të natyrës së njëjtë apo të ngjashme dhe dëshmi të tjera si referenca pozitive apo raporte të pranimit teknik, apo edhe transaksione bankare ose fatura tatimore të shitjes kur kemi të bëjmë me kompani private*.

Sipas kërkesave të lartpërmendura, OE ankues në ofertë ka dorëzuar një listë të kontratave me të dhënat e kërkuara, prej listës së kontratave shihet se sa i përket natyrës së punëve të ngjashme këto kontrata e përmbushin kriterin e kërkuar, po ashtu edhe shuma e këtyre

kontratave arrinë vlerën e kërkuar për kontrata të ngjashme. Kur jemi tek kriteri se të paktën njëra nga kontratat për punë të ngjashme duhet të jetë furnizim, eksperti sqaron se për kontratën e ngritur edhe në pretendimin e ankesës (kontrata 6 sipas listës së kontratave në ofertë), sipas analizimit të bërë nga eksperti, nga titulli i aktivitetit të prokurimit duket se ka të bëjë më shumë me punë ndërsa nëse analizohen pozicionet në paramasë dhe parallogari, rezulton se shumica e këtyre pozicioneve në këtë aktivitet prokurimi kanë të bëjnë me furnizim të materialeve të kërkuara përmes atij aktiviteti, pra pjesa më e madhe e vlerës së kësaj kontrate sipas paramasës dhe parallogarisë ka të bëjë me furnizim dhe sipas mendimit të ekspertit, kjo kontratë përmbush kriterin e kontratës për furnizim të paraqitur në FDT dhe si e tillë konsiderojmë që është dashur të pranohej edhe nga autoriteti kontraktues.

Nga sqarimet e bërë më lartë vlerësojmë se pretendimi i ngritur nga operatori ankues është i bazuar.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **NDËRMARRJA PUBLIKE BANESORE SH.A.**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **FIN COMPANY SH.P.K.**

Agnese Ibrahimi